FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION
Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 43 Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.
Tel.Fax: ++381 (0) 38 244 473, mobil:
e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. **105/2025**
Prishtinë, më 25.09.2025

V E N D I M

Për shqyrtimin e kërkesave të klubeve të pezulluara për ri-licencim

Këshilli Drejtues i Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë **25.09.2025** në Prishtinë, pas shqyrtimit të pikës së dytë të rendit të ditës: *"Shqyrtimi i kërkesave të klubeve të pezulluara për ri-licencim"*, me vota unanime

V E N D O S I:

1. Të hiqet pezullimi i klubeve të pezulluara, në parim.
2. Të bëhet kontrolli i detajuar i **procesverbaleve** të klubeve për të siguruar rregullshmërinë e dokumentacionit.
3. Të gjitha klubet (aktive dhe të pezulluara) obligohen të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesës së **Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit** dhe **Federatës**, duke përfshirë edhe **kontratat e sportistëve**.
4. Vendimi për ri-licencimin e klubeve të pezulluara është i vlefshëm **deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Federatës**, ku do të bëhet miratimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i FSHSK-së

Gëzim Hazrolli